- Liferimi i pjesëve të ndërrimit me kualitet adekuat
- Mirëmbajtja dhe operimi në nivel teknik të kërkuar
- Kryerja e remonteve me kohë dhe kualitative

Përmbajtja e qymyrit të mihjeve:

- Aftësia e ulët termike 6700 – 9210 kJ/kg, vlera projektuese 7325.5 kJ/kg
- Përmbajtja e hirit 14 – 21 %
- Përmbajtja e lagështisë 38 – 47 %
- Përmbajtja e sulfurit gjatë djegies është 0.3 %

Llogaritja e koeficientit të efiçencës në prag do të jetë:

- Llogarisim me vlerë të aftësisë termike të qymyrit 7325 kJ/kg
- Harxhimi specifik i qymyrit në TC Kosova A $h_{sq}=1.52$ ton/MWh në gjenerator
- Harxhimi specifik i qymyrit në TC Kosova B $h_{sq}=1.267$ ton/MWh në gjenerator

Llogaritja e koeficientit të efiçencës së energjisë së Termocentraleve Kosova A dhe B:

$$\text{TC Kosova A} \quad \eta = 7325 * 1.52 = 11134 \text{ kJ/kWh}$$

$$E_f = E_d / \eta * 100\% = 3600 / 11134 = 32.34 \%$$

$E_d=3600$ kcal/kWh- energjia specifike elektrike

η -energjia specifike e mesme e qymyrit në hyrje (termike)

$$\text{TC Kosova B} \quad \eta = 7325 * 1.267 = 9280 \text{ kJ/kWh}$$

$$E_f = E_d / \eta * 100\% = 3600 / 9280 = 38,79 \%$$

1.14 TË DHËNAT E RRJETIT TË TRANSMETIMIT

1.14.1 Të dhënat e kapaciteteve transmetuese (linjave)

Tabela 1.24. Të dhënat e kapaciteteve transmetuese

Niveli i tensionit	Gjatësia totale km
400 KV	279.5
220 KV	238.5
110 KV	912.1

Gjatësia e linjave të nivelit 220kV, ka ndryshuar pas implementimit të projektit të NS Drenasi dhe linjës 110kV NS Rahoveci-NS Theranda.

1.14.2 Të dhënat e kapaciteteve transformuese

Tabela 1.25. Të dhënat e kapaciteteve transformuese

Niveli i tensionit kV	Numri i transformatorëve	Fuqia e instaluar MVA
400/220	3 x 400	1200
400/110	4 x 300	1200
220/110	9 x 150	1350
220/35	2 x 160	320
220/35/10(20)	2x40	80
220/10(20)	2x40	80
110/35/10(20)	65	2329

**1.15 PLANI I RIPARIMEVE ME INTERKONEKSION DHE LINJAVE ME RËNDËSI PËR INTERKONEKSIONIN**

Tabela 1.25. Të dhënat e kapaciteteve transformuese

Përshkrimi	Linja	Ditët e nevojshme për remont	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor
Linja te interkoneksionit	Linja 400 kV Kosove B – Nish	3							25-27
	Linja 400 kV Ferizaj 2 – Shkupi 5	3							11-16
	Linja 400 kV Peje 3 – Ribarevine	2	08-17	18-27					
	Linja 400 kV Kosove B – Koman	3	01-02				30		
	Linja 220 kV Podujeve – Krusheveci	2	27-29						
	Linja 220 kV Prizreni 2 – Fiereza	4			05-07				07-08
Linja sinjifikante (kane ndikim ne interkension)	Linja 400 kV Kosove B – Peje 3	3			16-18				
	Linja 400 kV Kosove B – Ferizaj 2	2			22-23				
	Linja 220 kV Drenas – Drenas 1	1						23-23	
	Linja 220 kV Drenas 1 – Prizreni 2	3						27-29	
	Linja 220 kV Kosove B - Podujeve	3				28-30			

Plani i riparimit të linjave interkonektive për vitin 2021, është harmonizuar me OST rajonale, në gjysmën e dytë të muajit Nëntor 2020, në takimin e grupit punues rajonal OPC (Outage Planning Coordination).



1.16 PROJEKTET E PARAPARA PËR VITIN 2021

Për vitin 2021 nuk do të kemi ndonjë energjizim për linja të reja gjithashtu edhe për nënstacione të reja:

Për momentin janë në fazë të tenderimit projektet:

- LOT 1: Ndërtimi i NS 110/10(20) kV (Kastriot) Ferizaj 3;
- LOT 5: Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastriot-Ferizaj 3;
- LOT 2: Ndërtimi i Nënstacionit të ri - GIS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova;
- LOT 4: Furnizimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova
- LOT 3: Ndërtimi i Nënstacionit të ri - AIS 220/35/10(20) kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV
- LOT 4: Furnizimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 220/35/10(20) kV Malisheva

Ndërsa linja e Fushë Kosovës e paraparë me projektet e EBRD LOT3 pritet të përfundohet dhe të lëshohet në punë pa ngarkesë por jo edhe të energjizohet pa u ndërtuar nënstacioni i Fushë Kosovës (i cili është në fazën e tenderimit).



2 BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE 2021

2.1 NQ TERMOKOS

2.1.1 Sistemi i Energjisë Termike

NP “Termokos” Sh.A. është furnizuesi i vetëm i energjisë termike (ngrohjes qendrore) në Prishtinë. Krahas ngrohjes qendrore, NP “Termokos” Sh.A. gjithashtu ofron edhe shërbime të mirëmbajtjes të sistemit të ngrohjes qendrore për konsumatorët e saj. Kërkesa për ngrohje qendrore të ofruar nga NP “Termokos” Sh.A. është jashtëzakonisht e lartë. Kjo për arsye se NP “Termokos” Sh.A. ofron ngrohje kualitative, 24 orë gjatë gjithë sezonit ngrohës, me një çmim më të lirë se sa alternativat tjera të ngrohjes.

Aktualisht, NP “Termokos” Sh.A. ofron ngrohje qendrore për 14,961 konsumator (prej të cilëve 13,572 janë konsumator shtëpiak dhe 1,389 konsumator komercial e institucional), përderisa numri i konsumatorëve potencial që parashihet të kyçen në sistemin e ngrohjes qendrore të NQ Termokos për sezonin 2020/2021 është përafërsisht 642 konsumatorë (prej të cilëve 549 konsumatorë shtëpiak dhe 93 konsumatorë komercial e institucional). NP “Termokos” Sh.A. mbulon kërkesën për ngrohje të konsumatorëve ekzistues duke mos shfrytëzuar tërësisht kapacitetin ekzistues. Kjo dërgon drejt konkluzionit që NP “Termokos” Sh.A., mund të ofrojë ngrohje qendrore për konsumatorë të rinj, të kategorive të ngjashme me konsumatorët ekzistues, gjegjësisht një bazë konsumatorësh me kombinatorikë të përafërt me profilin e konsumatorëve të amvisërisë dhe komercial e institucional.

2.1.2 Kapacitetet prodhuese të energjisë termike

Njësi bazë gjeneruese e energjisë termike është TC Kosova B, përmes sistemit të kogjenerimit. Kapaciteti i instaluar është 140 MW_{TH}, ndërsa kapaciteti operativ vlerësohet të jetë 137.48 MW_{TH}. Për prodhimin e energjisë termike shfrytëzohet avulli i cili ekstrahohet nga shkalla e PM e të dy turbinave në këtë termocentral. Këmbimi i energjisë avull/ujë bëhet në stacionin për ekstraktim të energjisë - HES, përmes dy këmbyesve me kapacitet nga 70MW_{TH}. Ky stacion është në afërsi të TC Kosova B, dhe në tërësi menaxhohet nga Termokosi.

Termokosi disponon edhe me kapacitete të veta të prodhimit të energjisë termike, kaldajat me lëndën djegëse mazut, të cilat janë përdorur para funksionalizimit të sistemit të kogjenerimit. Këto njësi prodhuese janë funksionale dhe mund të përdoren në raste specifike (mbulimi i kërkesave të energjisë në pikun e ngarkesës, dhe në rast të ndërprerjes së furnizimit nga KEK – TC Kosova B).

Tab. 2.1 Kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit të energjisë termike - NQ Termokos



Njesia gjeneruese	Kapaciteti instal.	η (%)	Kapaciteti operativ	Lënda djeg.	Kons l.d. Kg/ MWh	Viti i prodh/ins	Vendi
Sistemi i kogjen. TC Kosova B	2x70= 140MW _{TH}	98	137.48 MW _{TH}	Linjit	-	2014	TC Kosova B
Kaldaja me ujë të nxehtë	2x58 = 116MW _{TH}	85	98.6 MW _{TH}	Mazut	105	1978	Termokos
	2x7= 14MW _{TH}	90	12.6 MW _{TH}	Dizel	96	1983	Ngroh. e QKUK
	4 MW _{TH}	90	3.6 MW _{TH}	Mazut	96	2003	Termokos
Total kapac. Ngrrohtores	134 MW _{TH}	85.6	114.8 MW _{TH}	-	-	-	-
Total kapacit. gjenerues	274 MW _{TH}	92	252.28 MW _{TH}	-	-	-	-

Rrjeti i transportimit të energjisë termike nga TC KOSOVA B deri ne stacionin e pranimit të energjisë – HRS në NQ Termokos është me gjatësi prej 10.5 km.

2.1.3 Rrjeti i shpërndarjes – NQ Termokos

Rrjeti primar i shpërndarjes me gjatësi të tubacionit prej 82 km dhe kapacitet të ujit prej rreth 3,500 m³, është i instaluar kryesisht në vitet e 70-ta, në pjesën e urbanizuar të Prishtinës. Përkundër investimeve posaçërisht në vitet e fundit rreth 60% e rrjetit është me gypa të rinjë të paraizoluar kurse pjesa tjetër me gypa të amortizuar.

Tab. 2.2 Karakteristikat kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes - NQ Termokos

Rrjeti i shpërndarjes dhe Nënstacionet - NQ Termokos		
Numri i Nënstacioneve	Gjatësia e rrjetit - tubacionit (km)	Numri i matësve në termonënstacione
460 total (443 aktive dhe 17 pasive)	82	Nga 443 nënstatione aktive në 350 nënstatione janë të vendosur matësit dhe janë funksional, kurse në 93 nënstatione (kryesisht nënstatione te vogla për nga kapaciteti) nuk ka matës ose nuk është funksional.

2.1.4 Planifikimi i zhvillimit të sistemit të energjisë termike – NQ Termokos

Termokosi, planet afatgjata për prodhimin e energjisë termike i bazon në sistemin e kogjenerimit, si burim i sigurt, ekonomikisht i favorshëm dhe i përshtatshëm në kuptim të mbrojtjes së ambientit. Kapaciteti aktual prej 140 MW_{TH} (2x70 MW_{TH}) dhe aftësia bartëse e termopërquesit (Rrjetit të transportit të energjisë termike) TC Kosova B – Termokos prej 160 MW, janë faktorë limitues për ekstraktim më të madh energjisë.



Në vitet e ardhshme priten investime të mëdha për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes, që rezultojnë në rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore të Termokos. Detajet janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tab. 2.3 Skenari 1. Projektioni i Mesëm - NQ Termokos

Viti	Investimet/ mil €	Zgjerimi i sipërfaqes m ²	Sipërfaqja aktuale e kyçur	Sipërfaqja totale e kyçur
2020	1-2.5	34,856	1,386,124	1,420,980
2021	2.5-3	69,711	1,420,980	1,490,691

2.1.5 Parashikimi i kërkesës për energji termike – NQ Termokos

Projektionet zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NQ Termokos kryesisht përfshijnë planifikimet për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes e rrjedhimisht rritjen e bazës së konsumatorëve / sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes.

Parashikimi i kërkesës për energji termike mund të bazohet në kërkesën/ konsumin në rritje në tri sezonet e fundit. Në sezonet e mëhershme (para funksionalizimit të kogjenerimit) furnizimi me ngrohje nga NQ Termokos nuk ka qenë në nivelin e duhur, prandaj edhe kërkesa për kyçje në sistemin e ngrohjes qendrore ka qenë e papërfillshme.

Numri i konsumatorëve të rinj, përveç nga fizibiliteti i zgjerimit të rrjetit në pjesë të caktuara të qyteti, determinohet edhe me kapacitetin energjetik në dispozicion nga sistemi i kogjenerimit, i cili aktualisht është 140MW_{TH}.

Për hartimin e këtij Bilanci është marrë projektioni (skenari) i mesëm. Siç vërehet nga tabela 2.3, për vitin 2021 është parashikuar një rritje e sipërfaqes ngrohëse prej 69,711 m². Ky parashikim për rritje është bazuar kryesisht në projektin për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit të Komisionit Evropian i cili do të përfundohet tërësisht në fund të vitit 2020, e gjithashtu me zhvillim gradual të projektit të KfW.

Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës respektivisht furnizimit me energji termike i ndarë sipas muajve për vitin 2021.



Tab. 2.4 Parashikimi i kërkesës për energji termike - NQ Termokos në vitin 2021

KËRKESA E KONSUMATORËVE PËR ENERGJI TERMIKE – VITI 2021									
	Konsumatorët Shtëpiak			Konsumatorët Komercial e Institucional			Total Konsumatorët		
	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)
Janar	820,000	73.80	26,216	585,000	64.35	24,199	1,405,000	138.15	50,415
Shkurt	822,000	73.98	21,321	590,000	64.90	19,681	1,412,000	139	41,002
Mars	825,000	74.25	19,802	590,000	64.90	18,279	1,415,000	139.15	38,081
Prill	830,000	74.70	7,292	595,000	65.45	6,731	1,425,000	140	14,023
Tetor	830,000	74.70	8,213	595,000	65.45	7,581	1,425,000	140.15	15,794
Nëntor	852,566	76.73	21,330	603,269	66.36	19,689	1,455,835	143	41,019
Dhjetor	852,566	76.73	26,228	603,269	66.36	24,210	1,455,835	143.09	50,438
Total / Mes. *	833,162	74.98	130,402	594,506	65.40	120,371	1,427,667	140.38	250,773

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kërkesa e planifikuar për energji termike përfshirë edhe humbjet në rrjet.

Tab. 2.4.1: Parashikimi i kërkesës për energji termike plus humbjet në rrjet për vitin 2021

KËRKESA PËR ENERGJI TERMIKE (KËRKESA E KONSUMATORËVE PLUS HUMBJET NË RRJET) – VITI 2021									
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total	
Kërkesa e konsumatorëve për energji termike (MWh)	50,415	41,002	38,081	14,023	15,794	41,019	50,438	250,773	
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	4,563	3,711	3,447	1,269	1,430	3,713	4,565	22,698	
Total kërkesa e kons. plus humbjet (MWh)	54,978	44,713	41,528	15,292	17,224	44,732	55,003	273,471	

2.1.6 Parashikimi i humbjeve në rrjet – NQ Termokos

Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike (TC Kosova B – NQ Termokos) dhe në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.

Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike TC Kosova B - N.P Termokos, parashihet të jenë 2% apo 5,458 MWh_{TH}.

Në vitin 2021, në rrjetin e shpërndarjes, parashihet nivel i humbjeve prej 8.3%, që paraqet një zvogëlim mesatar të nivelit të humbjeve prej 0.6% në krahasim me vitin / sezonin e kaluar.

Është e pritshme që ndikim në zvogëlimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, të ketë realizimi i projektit për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit nga Komisionit Evropian, i cili është në përfundim – pritet të përfundohet në fund të vitit 2020.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur detajet për humbjet në rrjetin e transportit (kogjenerimit, TC Kosova B – NP Termokos) dhe për humbjet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021.



Tab. 2.5 Humbjet në rrjetin e transportit dhe të shpërndarjes së energjisë termike - NQ Termokos në vitin 2021

Muaji	Humbjet Sasiore në rrjetin e trans. (MWh _{TH})	Humbjet në rrjetin e trans. (%)	Humbjet Sasiore në rrjetin e shpërnd. (MWh _{TH})	Humbjet në rrjetin e shpërnd. (%)	Humbjet totale në rrjet (MWh _{TH})	Humbjet totale në rrjet (%)
Janar	1,102	2.0%	4,563	8.3%	5,665	10.3%
Shkurt	892	2.0%	3,711	8.3%	4,603	10.3%
Mars	827	2.0%	3,447	8.3%	4,274	10.3%
Prill	302	2.0%	1,269	8.3%	1571	10.3%
Tetor	341	2.0%	1,430	8.3%	1,771	10.3%
Nëntor	892	2.0%	3,713	8.3%	4,605	10.3%
Dhjetor	1,102	2.0%	4,565	8.3%	5,667	10.3%
Total	5,458	2.0%	22,698	8.3%	28,156	10.3%

2.1.7 Prodhimi i energjisë termike – NQ Termokos

Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin). Gjithashtu planifikimet për prodhimin e energjisë termike reflektojnë edhe humbjet në rrjet, si dhe eficiencën e energjisë.

Siç është thënë më lartë NQ Termokos prodhimin e energjisë termike e bazon në stabilimentet e kogjenerimit në TC Kosova B me kapacitet nominal prej 140MW_{TH}. Mirëpo, NQ Termokos disponon me kapacitet e veta rezervë të prodhimit me kapacitet nominal prej 134 MW_{TH}, që planifikon t'i shfrytëzoj për periudha të shkurta kohore, vetëm në rast të ndërprerjeve të pa planifikuara të stabilimenteve të kogjenerimit në TC Kosova B. Prodhimi i parashikuar bruto nga stabilimentet e ngrohtores së NP Termokos është 6,819.72 MWh_{TH} duke marrë parasysh efikasitetin e kaldajave prej 85%, ndërsa bruto prodhimi i energjisë termike nga impiantet e kogjenerimit, si bartës kryesor i prodhimit, është shumë më i madh 272,896 MWh_{TH}.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur parashikimet vjetore (për vitin 2021) të prodhimit bruto të energjisë termike nga kogjenerimi dhe nga kapacitetet prodhuese të ngrohtores.

Tab. 2.6 Prodhimi bruto vjetor i energjisë termike - NQ Termokos në vitin 2021

Prodhimi bruto i energjisë termike	
Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi-TC Kosova B (MWh _{TH})	272,896
Prodhimi i energjisë termike në ngrohtore (MWh _{TH})	6,820
Total bruto prodhimi (MWh_{TH})	279,716

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat për prodhimin bruto dhe neto të energjisë termike sipas muajve të vitit 2021.



BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TERMIKE PËR VITIN 2021

Tab. 2.7 Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike sipas muajve - NQ Termokos në vitin 2021

PRODHIMI I ENERGJISË TERMIKE - VITI 2021								
Përshkrimi/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Mesatare
Energjia nga lënda djegëse (MWh)	1,337	1,337	1,337	669	669	1,337	1,337	8,023
Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore (%)	85%	85%	85%	85%	85%	85%	85%	85%
Bruto prodhimi në stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (MWh)	1,137	1,137	1,137	568	568	1,137	1,137	6,820
Bruto prodhimi në stabilimentet e kogjenerimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	55,104	44,608	41,328	15,088	17,056	44,608	55,104	272,896
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)	56,241	45,745	42,465	15,656	17,624	45,745	56,241	279,716
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	1,102	892	827	302	341	892	1,102	5,458
Konsumi vetanak (MWh)	160	140	110	62	60	120	135	787
Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)	54,979	44,713	41,528	15,292	17,223	44,733	55,004	273,471

2.1.8 Bilanci vjetor i energjisë termike – NQ Termokos

Tab. 2.8 Bilanci vjetor i energjisë termike - NQ Termokos në vitin 2021

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera
1	Energjia nga lënda djegëse - mazuti	(MWh _{TH})	8,023
2	Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore	(%)	85%
3	Prodhimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të Ngrohtores	(MWh _{TH})	6,820
4	Prodhimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh _{TH})	272,896
5	Total Bruto Prodhimi i energjisë termike	(MWh _{TH})	279,716
6	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh _{TH})	5,458
7	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	2.0%
8	Konsumi vetanak	(MWh _{TH})	787
9	Neto Prodhimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	273,471
10	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	22,698
11	Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	(%)	8.3%
12	Furnizimi me energji termike	(MWh _{TH})	250,773
13	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	710
14	Sipërfaqja ngohëse - mesatarja vjetore	m ²	1,427,667
15	Numri i nënstacioneve termike (aktive / pasive)	-	443/17
16	Kapaciteti i instaluar prodhues	MW	274
17	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	84

2.2 NQ GJAKOVA

2.2.1 Sistemi i energjisë termike

N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. në Gjakovë ofron shërbimet e ngrohjes qendrore duke operuar në sektorin publik, komercial dhe atë të amvisërisë në territorin e qytetit të Gjakovës.

Për shkak të kostos së lartë të lëndës djegëse – mazutit – me të cilin operojnë kaldajat, që paraqet vështirësi për ta përballuar financiarisht, NQ Gjakova ofron një furnizim të reduktuar. Një operim normal dhe i pavarur do të arrihet me lëshimin në punë të impiantit të ri të Ngrohtores dhe një njësie të kogjenerimit të energjisë elektrike dhe asaj termike, i cili është financuar nga fondet e Komisionit Evropian, si pjesë e programit IPA II (2015).

2.2.2 Kapacitetet për Prodhimin e Energjisë Termike

N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë do të ketë në dispozicion dy njësi (kaldaja) për prodhim vetëm të energjisë termike kapacitet total të instaluar 11 MW_{TH} dhe njësisë së kogjenerimit me kapacitet 4 MW_{TH} dhe 1.1 MW_{EL} që shfrytëzojnë lëndën djegëse biomasë; karakteristikat teknike sikurse në vijim:

Tab. 2.9 Karakteristikat teknike të kaldajave – NQ Gjakova

TË DHËNAT PËR KAPACITETET E PRODHIMIT TË ENERGJISË TERMIKE					
Njësia prodhuese	Viti i lëshimit në punë	Kapaciteti i instaluar termik (MW)	Kapaciteti termik ne dispozicion (MW)	Efikasiteti termik (%)	Lloji i lëndës djegëse
Njësia 1 - CHP	2021	4 (TH) 1.1 (EL)	3.4 (TH)	85%	Biomassë
Njësia 2 - HoB	2021	5.5 (TH)	4.68 (TH)	85%	Biomassë
Njësia 3 HoB	2021	5.5 (TH)	4.68 (TH)	85%	Biomassë
Total		15 (TH); 1.1(EL)	12.76 (TH)	85%	

2.2.3 Rrjeti i Shpërndarjes – NQ Gjakova

Rrjeti i shpërndarjes i N.P. ‘Ngrohtorja e Qytetit’ SH.A. në Gjakovë ndahet në dy degëzime, siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme.



Tab. 2.10 Karakteristikat e rrjetit të shpërndarjes – NQ Gjakova

	Rrjeta e vjeter	Rrjeta e re
Orientimi	Pjesa veriore	Pjesa Jugore
Drejtimi	Nga Sh.F. Zekeria Rexha	Nga Spitali I Qytetit
Viti I fillimit të shtrirjes së rrjetit	1980	2001
Lloji I rrjetit	Gypa Klasik në kanal betoni	Me gypa të paraizoluara

Furnizimi me ngrohje bëhet me sistem indirekt të ngrohjes (përmes këmbyesve të nxehtësisë në nënstacionet termike).

Sistemi i rrjetit është dy-gypor-indirekt; bazuar në vlerësimet e studimit të fundit të fizibilitetit rrjeti primarë i shpërndarjes është me gjatësi prej rreth 15.5 km trase / 31 km gyp. Numri total i nënstacioneve është 302, ndërsa aktualisht janë aktiv 180 nënstacione termike.

2.2.4 Parashikimi i zhvillimit të sistemit të energjisë termike – NQ Gjakova

NQ Gjakova, planet afatgjata për prodhimin të energjisë termike i bazon në projektin aktual për ngrohtoren e re që përfshinë edhe njësinë e kogjenerimit me lëndën djegëse biomasë, që është në fazën finale të ndërtimit dhe fillimit të lëshimit në punë. Ky projekt do të ketë ndikim në krijimin e një burimi të sigurt, ekonomikisht të favorshëm dhe i përshtatshëm në kuptim të mbrojtjes së ambientit. Kapacitetet aktuale prodhuese që priten të lëshohen në punë në fillim të vitit 2021 janë:

- Njësitë (kaldajat) për prodhimin vetëm të energjisë termike me kapacitet nominal $2 \times 5.5 \text{ MW}_{\text{TH}}$;
- Njësia e kogjenerimit të energjisë elektrike dhe asaj termike me kapacitetet $1.2 \text{ MW}_{\text{EL}}$ dhe 4 MW_{TH} ;

Gjithashtu janë instaluar edhe rezervuarët për ruajtjen e nxehtësisë prej 500 m^3 ($2 \times 250 \text{ m}^3$).

Si aktivitete pasuese të projektit për ngrohtoren e re, në vitet e ardhshme priten investime të konsiderueshme në rrjetin e ngrohjes, për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit, që do të rezultojnë në zgjerimin e bazës së konsumatorëve përkatësisht rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore të NQ Gjakova.

Planifikohet një rritje e vogël e sipërfaqes ngrohëse prej rreth $12,000 \text{ m}^2$, ashtu që sipërfaqja ngrohëse në vitin 2021 të arrijë në $95,000 \text{ m}^2$ - detajet janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tab. 2.11 Zgjerimi i planifikuar i sipërfaqes ngrohëse – NQ Gjakova në vitin 2020

Viti	Sip. Ngroh. Aktuale (m ²)	Zgjerimi I sip. Ngroh. (m ²)	Sip. Ngroh. Totale e kyçur (m ²)
2020	83,000	-	83,000
2021	83,000	12,000	95,000



2.2.5 Parashikimi i kërkesës për energji termike – NQ Gjakova

Projeksionet afatgjata zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NQ Gjakova për prodhimin e energjisë termike kryesisht i bazon në projektin e tanishëm për ngrohtoren e re që përfshinë edhe njësinë e kogjenerimit me lëndën djegëse biomasë. Po ashtu këto projeksione zhvillimore përfshijnë planifikimet për rehabilitim të rrjetit ekzistues dhe për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes. Kjo do të ndikoj në rikthimin e konsumatorëve (aktualisht “pasiv”) dhe në rritjen e bazës së konsumatorëve, e rrjedhimisht ndikon në rritjen e sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes. Gjithashtu projeksionet zhvillimore do të ndikojnë në zvogëlimin e humbjeve në rrjet dhe përgjithësisht në sistem.

Duke qenë se në vitin 2021 planifikohet të startoj operimi i Impiantit të ri me lëndë djegëse biomasë, pritet një përmirësim i dukshëm i furnizimit me energji termike për ngrohje.

2.2.6 Detaje për parashikimin afatgjatë të kërkesës – NQ Gjakova

Për vitin 2021 parashihet një rritje shumë e vogël e sipërfaqes ngrohëse prej rreth 12,000 m² (tabela 2.11 më lartë), që kryesisht në këtë rritje pjesën më të madhe do të ketë rikthimi i konsumatorëve ‘pasiv’.

Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës respektivisht furnizimit me energji termike.

Tab. 2.12 Parashikimi i furnizimit / kërkesës për energji termike - NQ Gjakova në vitin 2021

KËRKESA E KONSUMATORËVE PËR ENERGJI TERMIKE – VITI 2021									
	Konsumatorët Shtëpiak			Konsumatorët Komerc. e Instituc.			Total Konsumatorët		
	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)
Janar	42,280	4.23	1,280	40,720	4.89	1,290	83,000	9.11	2,570
Shkurt	42,280	4.23	1,180	40,720	4.89	1,190	83,000	9.11	2,370
Mars	42,280	4.23	787	40,720	4.89	798	83,000	9.11	1,585
Prill	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tetor	50,600	5.06	802	41,400	4.97	657	92,000	10.03	1,459
Nëntor	52,250	5.23	1,670	42,750	5.13	1,362	95,000	10.36	3,032
Dhjetor	52,250	5.23	1,787	42,750	5.13	1,461	95,000	10.36	3,248
Total / Mes.	46,990	4.70	7,506	41,735	4.98	6,758	88,500	9.68	14,264

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kërkesa e planifikuar për energji termike përfshirë edhe humbjet në rrjet.

Tab. 2.12.1: Parashikimi i kërkesës për energji termike plus humbjet në rrjet për vitin 2021



KËRKESA PËR ENERGJI TERMIKE (KËRKESA E KONSUMATORËVE PLUS HUMBJET NË RRJET) – VITI 2021								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Kërkesa e konsumatorëve për energji termike (MWh)	2,570	2,370	1,585	-	1,459	3,032	3,248	14,264
Total humbjet sasiore në rrjet (MWh)	642	590	399	-	365	757	813	3,566
Total kërkesa e kons. plus humbjet (MWh)	3,212	2,960	1,984	-	1,824	3,789	4,061	17,830

2.2.7 Parashikimi i humbjeve në rrjet – NQ Gjakova

Në vitin 2021 parashihet niveli i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes prej rreth 20%, më konkretisht humbjet sasiore në rrjet parashihet të jenë 3,566 MWh_{TH}, që është kryesisht si pasojë e rrjetit të vjetruar me gypa të pa izoluar (në pjesën verilindore të qytetit), rrjedhjeve të ujit në tubacione etj.

Në vitin 2021 planifikohet të ndërmerren riparime dhe rehabilitime emergjente të pjesëve më të dëmtuara të rrjetit, pra masa preventive për të mos u përkeqësuar gjendja respektivisht të mos tejkalohet ky nivel i parashikuar i humbjeve në rrjet. Në tabelën vijuese janë paraqitur parashikimet vjetore sipas muajve për humbjet sasiore dhe nivelet e humbjeve në përqindje në rrjetin e shpërndarjes.

Tab. 2.13 Parashikimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes - NQ Gjakova në vitin 2021

HUMBJET NË RRJET - VITI 2021								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/ Mesatare
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportimit (%)	-	-	-	-	-	-	-	-
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	642	590	399	-	365	757	813	3,566
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes (%)	20.00%	20.00%	-	-	-	20.00%	20.00%	20.00%
Total humbjet sasiore në rrjet (MWh)	642	590	399	-	365	757	813	3,566
Total humbjet në rrjet në përqindje (%)	20.00%	20.00%	-	-	-	20.00%	20.00%	20.00%

2.2.8 Parashikimi i prodhimit bruto dhe neto të energjisë termike – NQ Gjakova

Duke qenë se edhe në vitin 2021 do të fillohet operimi me impiantin e ri me lëndë djegëse biomasë-ashkëla të drurit, çmimi i së cilës është më i favorshëm se i mazutit, ashtu që do të arrihet të sigurohet një sasi e konsiderueshme e lëndës djegëse. Për këtë arsye për parashikimin e prodhimit të energjisë termike jemi bazuar rrjedhimisht në prodhim të plotë deri në fund të vitit. Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin).

Gjithashtu planifikimet për prodhimin e energjisë termike në vitin 2021 reflektojnë edhe humbjet në rrjet, si dhe efikasitetin termik të kaldajave. Në tabelën më poshtë janë paraqitur parashikimi i prodhimit bruto dhe neto i energjisë termike, sipas muajve për vitin 2021.

Tab. 2.14 Parashikimi i prodhimit bruto dhe neto të energjisë termike - NQ Gjakova në vitin 2021



BILANCI VJETOR I ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TERMIKE PËR VITIN 2021

PRODHIMI I ENERGJISË TERMIKE - viti 2021								
Përshkrimi/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Mes.
Energjia nga lënda djegëse (MWh)	3,934	3,626	2,483	-	2,232	4,617	4,967	21,859
Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore (%)	85%	85%	85%	-	85%	85%	85%	85%
Bruto prodhimi në stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (MWh)	3,344	3,082	2,111	-	1,385	2,865	3,082	15,868
Bruto prodhimi në stabilimentet e kogjenerimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	-	-	-	-	512	1,060	1,140	2,712
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)	3,344	3,082	2,111	0	1,897	3,924	4,222	18,580
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
Konsumi vetanak (MWh)	135	130	115	-	75	140	155	750
Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)	3,209	2,952	1,996	-	1,822	3,784	4,067	17,830

2.2.9 Bilanci vjetor i energjisë termike – NQ Gjakova

Tab. 2.15 Bilanci vjetor i energjisë termike – Gjakova 2021

BILANCI I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË TERMIKE - VITI 2021			
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera
1	Energjia nga lënda djegëse - mazuti	(MWh _{TH})	21,859
2	Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore	(%)	85%
3	Prodhimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të Ngrohtores	(MWh _{TH})	15,868
4	Prodhimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh _{TH})	2,712
5	Total Bruto Prodhimi i energjisë termike	(MWh _{TH})	18,580
6	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh _{TH})	-
7	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	-
8	Konsumi vetanak	(MWh _{TH})	750
9	Neto Prodhimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	17,830
10	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	3,566
11	Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	(%)	20.00%
12	Kërkesa / Furnizimi me energji termike	(MWh _{TH})	14,264
13	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	5,205
14	Sipërfaqja ngohëse	m ²	88,500
15	Numri i nënstacioneve termike (pasive/aktive)	-	302/180
16	Kapaciteti i instaluar prodhues	MW	15(TH); 1.1(EL)
17	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	31



2.3 Bilanci i përgjithshëm vjetor i energjisë termike 2021

Tab. 2.16 Bilanci i përgjithshëm i energjisë termike 2021

Nr.	Përshkrimi	Njësia	NQ Termokos	NQ Gjakova	Total Sektori
1	Energjia nga lënda djegëse - mazuti	(MWh _{TH})	8,023	21,859	29,882
2	Prodhimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të Ngrohtores	(MWh _{TH})	6,820	15,868	22,688
3	Prodhimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh _{TH})	272,896	2,712	275,608
4	Total Bruto Prodhimi i energjisë termike	(MWh _{TH})	279,716	18,580	298,296
5	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh _{TH})	5,458	-	5,458
6	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	2.00%	-	2.00%
7	Konsumi Vetanak	(MWh _{TH})	787	750	1,537
8	Neto Prodhimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrj. Shpërnd.	(MWh _{TH})	273,471	17,830	291,301
9	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	22,698	3,566	26,264
10	Humbjet në përqindje në rrejtin e shpërndarjes	(%)	8.3%	20.0%	9.0%
11	Furnizimi me energji termike	(MWh _{TH})	250,773	14,264	265,037
12	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	710	5,205	5,915
13	Sipërfaqja ngohëse	m ²	1,427,667	88,500	1,516,167
14	Numri i nënstacioneve termike (aktive / pasive)	-	443/17	302/180	767 / 190
15	Kapaciteti i instaluar prodhues i energjisë termike	MW _{TH}	274	15	289
16	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	84	31	115

Fundi i Dokumentit